



PAKO E GARANCIONIT TE PLOTË PER SISTEME FISKALE

ÇKA PËRFSHIHET NË PAKO:

Me shërbimin “Garancion i Plotë” nënkuptohen: shërbimet, intervenimet, ndërrimet dhe riparimet si ne vijim:

<ul style="list-style-type: none">• Asistencen telefonike: Përfshihen të gjitha thirrjet e kryera/pranuara nga tekniku i autorizuar
<ul style="list-style-type: none">• Asistencën në piken e instalimit të sistemit të gjitha ndërhyrjet në pikën ku është i instaluar sistemi fiskal si: kontrollim e funksionimit, hapje dhe ribllozim, resetim i pajisjes fiskale dhe rikthim i informacionit, rikonfigurim i databazes dhe sistemit operativ ne rast te korrupsionit, rikonfigurim i kanaleve te komunikimit, kontrollim i lidhjeve-kabllove te komunikimit dispenser-sistem fiskal dhe kabllot sistem fiskal-printer fiskal si dhe kontrollimin e komunikimit me serverin e ATK-se.
<ul style="list-style-type: none">• Zëvendësimin e pjesëve: Siq janë: prerësi i letres termike, njesia e printimit për kupona, njesia e printimit për arkiven, pllaka kryesore e printerit, pllaka e modemit të integruar, portet e komunikimit, tastet e jashtme të printerit. Kontrolleri i Dispenserit Elektronik (KDE), licenca fizike (HUSP key), main board i PC-së, kartela grafike, hard disku, ftofësi, power supply dhe tastet për kyçje/çkyçje. Demtimet e RS-porteve, Ethernet portit dhe USB porteve të brendshme si dhe defektet e shkaktuara nga luhatjet e tensionit, nga mbi ose nen tensioni.
<ul style="list-style-type: none">• Regjistrimi i nënartikujve të ri dhe modifikimi i ekzistuesve: sipas kërkesave të klientit në varësi të artikujve që ai shet dhe përcaktimeve të ATK-se.
<ul style="list-style-type: none">• Azhurimet e firmuerit të printerit dhe KDE: me versionet e fundit zyrtare, paraprakisht të certifikuar të organi kompetent.
<ul style="list-style-type: none">• Rifiskalizimi i pajisjes: Siq janë: numri i telefonit apo adresa, ndërrime që nuk kanë të bëjnë me ndërrimin e memories fiskale dhe plotësimin e informatave në sistemin informativ të ATK-së.
<ul style="list-style-type: none">• Rikonfigurimin e sistemit fiskal: në rast të humbjes së konfigurimit për ndonjë arsye, ri-caktim i kanaleve të komunikimit dhe realizimin e komunikimit të suksesshem Dispensere – Sistem Fiskal.
<ul style="list-style-type: none">• Rikonfigurim, azhurim dhe ri-instalim i fajllit për eksport.

Koha e intervenimit: në ditët e javës nga e Hëna deri të Premten prej orës 08:00 deri në orën 17:00 dhe ditën e shtunë prej orës 08:00 deri në orën 15:00. Asistenca teknike do të ofrohet brenda 72 orësh, nga momenti i njoftimit prej “Blerësit” për nevojën për intervenim në kuadër të shërbimit në fjalë, njoftim me shkrim apo telefon.

Çmimi i kontratës është në vlerë prej 10% të çmimit të blerjes së Sistemit Fiskal nga ana e blerësit.

NË ÇMIMIN E KONTRATËS NUK PËRFSHIHEN:

1. **MF** (memoria fiskale) dhe EJ-SD kartela janë material konsumi.
2. **Dëmtimet e shkaktuara** nga kushtet atmosferike, keqpërdorimi i sistemit fiskal, demtimi fizik, ndërhyrjet e paautorizuara, heqje apo demtim të bllozës, nuk përfshihen edhe demtimet nga forcat madhore, embargo, revolucion, bllokade, greva, nderhyrje ushtarake, apo prishje të rendit kushtetues, termeti, stuhite, permbytjet, epidemite, apo ndonjë katastrofë tjetër natyrore.

N.T.SH. ENTERNET, Nr. Fiskal: 600339205, Nr. biznesi: 70498596, adresa: Zona Industriale - Veternik, Prishtinë, Nr. telefoni: 038 603 231, E-mail: info@enternet-ks.com